

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 84/3 Prot.

Shkodër, më 09/02 /2022

**LËNDA:** Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE ✓

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,  
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;


- **Vendimin Administrativ nr. 95 datë 28.09.2021** për debitorin, z.Rei Riza Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal i identifikimi J60701093N, me adresë: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative nr.1, Tiranë.


Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

**KRYETAR**

**Aida DIZDARI**



  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**  
**Dega e Doganës Shkodër**

Nr. 770 / Prot.

6

Shkodër, më 28 .09 .2021

**V E N D I M**

**Nr. 95, datë 28.09.2021**

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, mori në shqyrtim shkresën nr.8123 prot., datë 07.05.2021 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.770 prot., datë 10.05.2021), të dërguar nga Drejtoria e Hetimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Lënda "Informacion për marrje vendimi", Procesverbalin për verifikimin e kontrabandës të mbajtur nga Drejtoria e Hetimit me numër serial 0006421 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.770/2 prot., datë 10.05.2021), Procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore të mbajtur nga Drejtoria e Hetimit me numër serial 0015530 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.770/1 prot., datë 10.05.2021) dhe aktet e tjera të hetimit doganor, lidhur me shkeljet doganore të konstatuar gjatë hetimeve të kryera për shtetasin **z.Rei Riza Shpuza**, i datëlindjes **01.07.1996**, me numër personal i identifikimi **J60701093N**, me adresë: **Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative nr.1, Tiranë**.

Pasi u shqyrtua dokumentacioni i mësipërm rezultoi se:

Në kuadër të procedurave hetimore për informacionin e sjellë në rrugë elektronike nga Drejtoria Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit për futjen në territorin doganor të mjeteve me targa të Mbretërisë së Bashkuar (Angleze) nga shtetas shqiptarë, në periudha të ndryshme, në lidhje me mjetet e markës;

- ***“Mercedes Benz, E Class, C-220 CDI, vit prodhimi 2007, me naftë, me targë BT07WCP dhe numër shasie WDB2110082B195193***, me drejtues shtetasin z. Rei Shpuza, sipas të dhënave nga sistemi TIMS, rezultoi që automjeti i sipërcituar ka hyrë në territorin shqiptar me datë 17.12.2016 nga pika kufitare e Muriqanit dhe nuk ka më dalje nga territori shqiptar pas kësaj date.
- ***“Mercedes Benz, C Class, C-220 CDI, vit prodhimi 2005, me naftë, me targë KN05WRL dhe numër shasie WDC2030082R182636***, me drejtues shtetasin z. Rei Shpuza, sipas të dhënave nga sistemi TIMS, rezultoi që automjeti i sipërcituar ka hyrë në territorin shqiptar me datë 23.02.2017 nga pika kufitare e Muriqanit dhe nuk ka më dalje nga territori shqiptar pas kësaj date.
- ***“Mercedes Benz, E Class, E-280 CDI, vit prodhimi 2006, me naftë, me targë OY56OLG dhe numër shasie WDB0202B027906***, me drejtues shtetasin z. Rei Shpuza, sipas të dhënave nga sistemi TIMS, rezultoi që automjeti i sipërcituar ka hyrë në territorin shqiptar me datë 20.03.2017 nga pika kufitare e Muriqanit dhe nuk ka më dalje nga territori shqiptar pas kësaj date.
- ***“Mercedes Benz, C Class, C-220 CDI, vit prodhimi 2005, me targë BT5KUS, me numër shasie WDC2030082R214056*** me drejtues shtetasin z. Rei Shpuza, sipas të dhënave nga

sistemi TIMS, rezulton që automjeti i sipërcituar ka hyrë në territorin shqiptar me datë 26.04.2017 nga pika kufitare e Muriqanit dhe nuk ka më dalje nga territori shqiptar pas kësaj date.

- **“Mercedes Benz, E Class, E-280 CDI, vit prodhimi 2006, me targë YP56OUO, me numër shasie WDB211020B052900** me drejtues shtetasin z. Rei Shpuza, sipas të dhënave nga sistemi TIMS, rezulton që automjeti i sipërcituar ka hyrë në territorin shqiptar me datë 13.06.2017 nga pika kufitare e Muriqanit dhe nuk ka më dalje nga territori shqiptar pas kësaj date.
- **“Mercedes Benz, E Class, E-250 CDI, vit prodhimi 2009, me targë M60BTA, me numër shasie WDD2120032A0756** me drejtues shtetasin z. Rei Shpuza, sipas të dhënave nga sistemi TIMS, rezulton që automjeti i sipërcituar ka hyrë në territorin shqiptar me datë 28.12.2018 nga pika kufitare e Muriqanit dhe nuk ka më dalje nga territori shqiptar pas kësaj date.

Me shkresën nr.28073/2 prot., datë 11.11.2019, Drejtoria e Hetimit administroi informacion pranë Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit, nëse janë kryer apo jo procedura doganore për automjetet e mësipërme, nga ku nuk është konstatuar që automjetet objekt hetimi të kenë kryer procedura të mëtejshme doganore.

Me shkresën nr.28073/5 prot., datë 11.11.2019, Drejtoria e Politikave të vlerësimit Doganor, na informon se vlera e detyrimit doganor për;

- automjetin objekt hetimi, **me targë BT07WCP dhe numër shasie WDB2110082B195193**, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 17.12.2016, **ka detyrim doganor të munguar në shumën 178.520 lekë.**
- automjetin objekt hetimi, **me targë KN05WRL dhe numër shasie WDC2030082R182636**, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 23.02.2017, **ka detyrim doganor të munguar në shumën 71.793 lekë.**
- automjetin objekt hetimi, **me targë OY56OLG dhe numër shasie WDB0202B027906**, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 20.03.2017, **ka detyrim doganor të munguar në shumën 86.793 lekë.**
- automjetin objekt hetimi, **me targë BT5KUS, me numër shasie WDC2030082R214056**, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 26.04.2017, **ka detyrim doganor të munguar në shumën 71.754 lekë.**
- automjetin objekt hetimi, **me targë YP56OUO, me numër shasie WDB211020B052900**, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 13.06.2017, **ka detyrim doganor të munguar në shumën 86.754 lekë.**
- automjetin objekt hetimi, **me targë M60BTA, me numër shasie WDD2120032A0756**, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 28.12.2018, **ka detyrim doganor të munguar në shumën 194.527 lekë.**

Të dhënat specifike, për automjetet objekt hetimi janë nxjerrë nga database online publike e autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar DVLA, referuar përgjigjes së autoriteteve doganore angleze, ku këta të fundit me shkresën e Drejtorisë së Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit me nr.9238/1 prot., datë 17.04.2019, ku këta të fundit na informojnë se të dhënat për

targat e automjeteve të Mbretërisë së Bashkuar mund të aksesohen nga faqja publike e sipërcituar DVLA.

Referuar fakteve të mësipërme, Drejtoria e Hetimit ka mbajtur procesverbalin për verifikimin e kontrabandës me nr. serial 0006421 datë 30.04.2021 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.770/2 prot., datë 10.05.2021) duke konsideruar veprimet dhe mosveprimet e shtetasit z.Rei Shpuza, shkelje doganore që konsiderohet kontrabandë referuar gjermës b të pikës 1, pikës 3 dhe 4 të nenit 256; gjermës a dhe d, të pikës 1, të nenit 276; të gjermës a dhe b, të pikës 1, të nenit 281 të Ligjit Nr. 8449/1999 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar dhe gjermës b, të pikës 1, të nenit 1, të pikës 4 të nenit 1, të pikës 3 të nenit 267; të pikës 2, të nenit 268 dhe nenit 269 të Ligjit Nr. 102/2014 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- do të penalizohet me gjobë në shumën **357.040 lekë**, dyfish i detyrimit doganor në zbatim të nenit 281 të ligjit Nr. 8449/1999 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar 1/b) “*gjobë nga dy deri ne pesëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt kontrabandë, pavarësisht nga dënimi i parashikuar ne Kodin Penal*”, për automjetin objekt hetimi, **me targë BT07WCP dhe numër shasie WDB2110082B195193**.
- do të penalizohet me gjobë në shumën **287.172 lekë**, katërfish i detyrimit doganor në zbatim të nenit 281 të ligjit Nr. 8449/1999 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar 1/b) “*gjobë nga dy deri ne pesëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt kontrabandë, pavarësisht nga dënimi i parashikuar ne Kodin Penal*”, për automjetin objekt hetimi, **me targë KN05WRL dhe numër shasie WDC2030082R182636** (i klasifikuar si përsëritës).
- do të penalizohet me gjobë në shumën **433.965 lekë**, pesëfish i detyrimit doganor në zbatim të nenit 281 të ligjit Nr. 8449/1999 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar 1/b) “*gjobë nga dy deri ne pesëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt kontrabandë, pavarësisht nga dënimi i parashikuar ne Kodin Penal*”, për automjetin objekt hetimi, **me targë OY56OLG dhe numër shasie WDB0202B027906** (i klasifikuar si përsëritës).
- do të penalizohet me gjobë në shumën **358.770 lekë**, pesëfish i detyrimit doganor në zbatim të nenit 281 të ligjit Nr. 8449/1999 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar 1/b) “*gjobë nga dy deri ne pesëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt kontrabandë, pavarësisht nga dënimi i parashikuar ne Kodin Penal*”, për automjetin objekt hetimi, **me targë BT5KUS, me numër shasie WDC2030082R214056** (i klasifikuar si përsëritës).
- do të penalizohet me gjobë në shumën **260.262 lekë**, trefish i detyrimit doganor në zbatim të nenit 268 të Ligjit Nr. 102/2014 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar 2 “*Autoritetet doganore vendosin sanksione administrative për rastet e kontrabandës në masën trefish të shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt kontrabande, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në Kodin Penal*”, **me targë YP56OUO, me numër shasie WDB211020B052900**.
- do të penalizohet me gjobë në shumën **1.167.162 lekë**, gjashtëfish i detyrimit doganor në zbatim të nenit 269 të Ligjit Nr. 102/2014 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar “*Në rastet e përsëritjes së kontrabandës (recidivism), sanksioni administrativ është dyfishi i sanksionit të përcaktuar në nenin 268. Ky sanksion nuk zbatohet nëse kanë kaluar 5 vjet nga data e pagesës së plotë të detyrimeve dhe të sanksionit të parë*”, për automjetin objekt hetimi, **me targë M60BTA, me numër shasie WDD2120032A0756**, (i klasifikuar si përsëritës).

Si rrjedhim, nga përlogaritja e afateve të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë rezulton se automjetet objekt hetimi, të cilët kanë hyrë në territorin shqiptar dhe nuk kanë pasur dalje, kanë thyer afatin e regjimit të lejimit të përkohshëm dhe referuar 273/2 të ligjit 8449/1999 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar, do të penalizohen sa gjysma e detyrimit doganor të shmangur, si më poshtë vijon;

- automjeti objekt hetimi, me targë *BT07WCP* dhe numër shasje *WDB2110082B195193*, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 17.12.2016, **penalizohet në shumën 89.260 lekë.**
- automjeti objekt hetimi, me targë *KN05WRL* dhe numër shasje *WDC2030082R182636*, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 23.02.2017, **penalizohet në shumën 35.896,5 lekë.**
- automjeti objekt hetimi, me targë *OY56OLG* dhe numër shasje *WDB0202B027906*, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 20.03.2017, **penalizohet në shumën 43.396,5 lekë.**
- automjeti objekt hetimi, me targë *BT5KUS*, me numër shasje *WDC2030082R214056*, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 26.04.2017, **penalizohet në shumën 35.877 lekë.**

Ndërsa nga përlogaritja e afateve të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë rezulton se automjeti me targë *YP56OUO*, me numër shasje *WDB211020B052900* i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 13.06.2017 dhe automjeti me targë *M60BTA*, me numër shasje *WDD2120032A0756*, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 28.12.2018 kanë thyer afatin e regjimit të lejimit të përkohshëm dhe referuar nenit 250/1/a, 259/1/b, dhe 269 të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shtetasi z. Rei Shpuza do të penalizohet me gjobë në shumën **20.000 lekë** (për automjetin me targë *YP56OUO*) dhe gjobë në shumën **35.000 lekë** (për automjetin me targë *M60BTA*).

Për shkeljen doganore të konstatuar (Thyerje të regjimit të lejimit të përkohshëm) u mbajt procesverbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative me nr.serial 0015530 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.770/1 prot., datë 10.05.2021).

Me shkresat nr.4396 prot., datë 24.02.2020, nr.4396/1 prot., datë 02.03.2020 dhe nr.3256 prot., datë 17.02.2021, Drejtoria e Hetimit njoftoi për tu paraqitur shtetasin z.Rei Shpuza me qëllim verifikimin dhe hetimin për procedurat doganore, i cili nuk u paraqit në datën dhe orën e caktuar.

Me anë të shkresës nr. 770/3 prot., datë 10.05.2021 Dega Doganore ka bërë njoftimin e procesverbalit për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore dhe procesverbalit për verifikimin e kontrabandës të mbajtur nga Drejtoria e Hetimit, me anë të së cilës shtetasi z.Rei Shpuza nuk ka marrë dijeni pasi zarfi është kthyer me shënimin “i panjohur” dhe pse adresa është marrë sipas çertifikatës personale të shtetasit nga platforma e -Albania.

Me shkresën nr.811 prot., datë 17.05.2021 Dega e Doganës Shkodër ka kërkuar informacion më të saktë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në lidhje me të dhënat personale dhe adresën e vendbanimit për shtetasin z.Rei Shpuza.

Referuar të dhënave të dërguara nga Zyra e Gjendjes Civile me shkresën nr.9018/1 prot., datë 14.06.2021 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.811/2 prot., datë 15.06.2021) të Bashkisë Shkodër, për shtetasin e sipërcituar, rezulton të jetë e njëjta adresë e dhënë.

Për vazhdimin e procedurave sa më të rregullta ligjore, Dega Doganore me shkresën nr.770/4 prot., datë 18.06.2021, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, referuar nenit 162 të ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” ka bërë kërkesë për shpallje publike të dy procesverbaleve të mbajtur nga Drejtoria e Hetimit.

Me shkresën nr. 2060/1 prot., datë 05.07.2021 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr. 770/5 prot., datë 07.07.2021) Bashkia Tiranë, Njësia Administrative nr.1, na konfirmon se shpallja për z. Rei Shpuza është afishuar në këndin e njoftimeve me datën 22.06.2021 dhe njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 162, të ligjit të sipërcituar. Si rrjedhim, shtetasi nuk ka paraqitur ankim mbrenda këtyre afateve.

Nga sa më sipër, në përmbledhje të fakteve të dhëna dhe informacionit që disponojmë, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, gjen të drejtë zbatimin e nenit 736 të VKM-së Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të pikës 1, 3 dhe 4 të nenit 256; të pikës 2, të nenit 273; të gërmës a, pikës 1, të nenit 276 dhe të gërmës b, të pikës 1, të nenit 281 të Ligjit Nr. 8449/1999 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i shfuqizuar dhe të gërmës b, pika 1, të nenit 250; pika 4, të nenit 250; gërmës b, pika 1, të nenit 259; pikës 3, të nenit 267; nenit 268 dhe 269 të Ligjit Nr. 102/2014 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe,

#### V E N D O S I:

1. Shpalljen debitor të shtetasit **z.Rei Riza Shpuza, me numër personal identifikimi J60701093N**, sipas specifikimeve të mëposhtme;

- Për, **automjetin objekt hetimi, me targë BT07WCP dhe numër shasie WDB2110082B195193, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 17.12.2016** të aplikohen sanksionet sipas ligjit 8449/1999 KD i shfuqizuar:

Detyrim doganor i munguar (neni 256/4)	178.520
Gjobë 2-fish i detyrimit doganor (neni 281/1/b)	357.040
Gjobë ½ e detyrimit të munguar (neni 273/2)	89.260
<b>Shuma</b>	<b>624.820 lekë</b>

*(gjashtëqindenzetekatërmijë e tetëqindenzetë) lekë*

- Për, **automjetin objekt hetimi, me targë KN05WRL dhe numër shasie WDC2030082R182636, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 23.02.2017** të aplikohen sanksionet sipas ligjit 8449/1999 KD i shfuqizuar:

Detyrim doganor i munguar (neni 256/4)	71.793
Gjobë 4-fish i detyrimit doganor (neni 281/1/b)	287.172
Gjobë ½ e detyrimit të munguar (neni 273/2)	35.896,5
<b>Shuma</b>	<b>394.861,5 lekë</b>

*(treqindënntëdhjetëekatërmijë e tetëqindegjashtëdhjetënjë presje pesë) lekë*

- Për, automjetin objekt hetimi, me targë OY56OLG dhe numër shasie WDB0202B027906, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 20.03.2017 të aplikohen sanksionet sipas ligjit 8449/1999 KD i shfuqizuar:

Detyrim doganor i munguar (neni 256/4)	86.793
Gjobë 5-fish i detyrimit doganor (neni 281/1/b)	433.965
Gjobë ½ e detyrimit të munguar (neni 273/2)	43.396,5
<b>Shuma</b>	<b>564.154,5 lekë</b>

*(pesëqindegjashtëdhjetëkatërmijë e njëqindpesëdhjetëkatër presje pesë) lekë*

- Për, automjetin objekt hetimi, me targë BT5KUS, me numër shasie WDC2030082R214056, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 26.04.2017 të aplikohen sanksionet sipas ligjit 8449/1999 KD i shfuqizuar:

Detyrim doganor i munguar (neni 256/4)	71.754
Gjobë 5-fish i detyrimit doganor (neni 281/1/b)	358.770
Gjobë ½ e detyrimit të munguar (neni 273/2)	35.877
<b>Shuma</b>	<b>466.401 lekë</b>

*(katërqindegjashtëdhjetëegjashtëmijë e katërqindënjë) lekë*

- Për, automjetin objekt hetimi, me targë YP56OUO, me numër shasie WDB211020B052900, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 13.06.2017, të aplikohen sanksionet sipas ligjit 102/2014 KD i ndryshuar:

Detyrim doganor i munguar (neni 250/4)	86.754
Gjobë 3-fish i detyrimit doganor (neni 268/2)	260.262
Gjobë (neni 259/1/b)	20.000
<b>Shuma</b>	<b>367.016 lekë</b>

*(treqindegjashtëdhjetëeshtatëmijë e gjashtëmbëdhjetë) lekë*

- Për, automjetin objekt hetimi, me targë M60BTA, me numër shasie WDD2120032A0756, i cili ka hyrë në territorin shqiptar në datë 28.12.2018, të aplikohen sanksionet sipas ligjit 102/2014 KD i ndryshuar:

Detyrim doganor i munguar (neni 250/4)	194.527
Gjobë 6-fish i detyrimit doganor (neni 268/2 dhe 269/1)	1.167.162
Gjobë (neni 259/1/b)	25.000
<b>Shuma</b>	<b>1.386.689 lekë</b>

*(një milion e treqindetëdhjetëegjashtëmijë e gjashtëqindetëdhjetëenëntë) lekë*

*Në total, borxhi doganor është në shumën 3.803.942 Lekë  
(tremilion e tetëqindetremijë e nëntëqindëdyzetëdy) lekë.*

2. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizimin e borxhit doganor.
3. Një e kopje e këtij vendimi i dërgohet Drejtorisë së Hetimit.

4. Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

**KRYETAR**

